

Perceptimi i **komunitetit serb** kundrejt **Policisë së Kosovës**

Mike apo armike?



Ky raport u prodhua falë përkrahjes financiare të Trustit Ballkanik për Demokraci, një projekt i Fondit Marshall Gjerman të Shteteve të Bashkuara.

B | T | D The Balkan Trust
for Democracy

A PROJECT OF THE GERMAN MARSHALL FUND

Botues: Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë

Autor: Shpat Balaj

Redaktor i brendshëm: Mentor Vrajolli

Ky raport në formën e tij origjinale është shkruar në gjuhën angleze

Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë falënderon Z. Veroljub Petronic dhe Humani Centar Mitrovica për asistencën e tyre në mbledhjen e të dhënave.

© Të gjitha të drejtat janë të rezervuara nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë. Të drejtat dhe pronësia intelektuale mbrohen nga Ligji Nr. 04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në sisteme elektronike apo të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, mekanik apo tjetër pa lejen me shkrim të botuesit. Nuk lejohet shfrytëzimi komercial i asnjë materiali të botuar nga Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS) pa lejen me shkrim të QKSS-së. Ju lutemi të kontaktoni: info@qkss.org ose +381 38 221 420.

Opinionet e shprehura në këtë botim nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të Trustit Ballkanik për Demokraci, të Fondit Marshall Gjerman të Shteteve të Bashkuara, ose të partnerëve të tij.

Perceptimi i komunitetit serb kundrejt Policisë së Kosovës

Mike apo armike?

Tabela e përmbajtjes

Gjetjet kryesore	5
Hyrje	6
Konteksti historik i marrëdhënieve të komunitetit serb të Kosovës me Policinë e Kosovës	8
Ndikimi politik mbi perceptimin e komunitetit serb të Kosovës kundrejt Policisë së Kosovës	13
Shqetësimet kryesore të sigurisë të komunitetit Serb në Kosovë	18
Rekomandime	24
Bibliografia	25

Gjetjet kryesore

- Qëndrimi i komunitetit serb kundrejt Policisë së Kosovës formësohet kryesisht nga politika e përditshme dhe zhvillimet e përgjithshme politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë;
- Komuniteti serb i Kosovës ka nivel të ulët besimi kundrejt Policisë së Kosovës. Mungesa e besimit është më e theksuar në Mitrovicën e Veriut kur krahasohet me rajonet e tjera në Kosovë. Për më tepër, komuniteti serb i Kosovës e konsideron Policinë e Kosovës si institucionin më të korruptuar në Kosovë;
- Shumica e shqetësimeve të sigurisë në komunat me shumicë serbe nuk janë të natyrës ndëretnike. Shqetësimet kryesore të sigurisë për komunitetet në komunat me shumicë serbe përfshijnë infrastrukturën e dobët, dhunën në familje, kafshët endacake, vjedhjet dhe aksidentet e trafikut;
- Qytetarët serb në Kosovë shprehin nivele më të larta të mosbesimit kundrejt policisë, dhe si arsye për këtë mosbesim jepen lidhjet ndërmjet strukturave politike, elementëve të krimit të organizuar dhe elementeve të policisë;
- Qytetarë serb në Veri të vendit shprehin nivel më të lartë frikës, çka çon në ngurrimin për të folur për krime të rënda, strukturat e pushtetit në veri dhe vrasjen e politikanit serb Oliver Ivanoviq;
- Sistemi i drejtësisë, veçanërisht Prokuroria e Shtetit, nuk siguron përgjigje efektive ndaj kërkesave të policisë, si dhe nuk ofron përditësime për lëndët e depozituara nga strukturat e policisë në komunat me shumicë serbe;
- Strukturat e Policisë së Kosovës në katër komunat veriore (Mitrovicë e Veriut, Zubin Potoku, Zveçan dhe Leposaviq) ballafaqohen me probleme në menaxhimin e flotës së automjeteve. Këtu përfshihen raportime për pamjaftueshmërinë e mjeteve teknike, siç janë automjetet, çka dëmton cilësinë e shërbimeve;
- Për shkak të mungesës së përkthyesve, Drejtoria Rajonale e Policisë së Kosovës e Mitrovicës së Veriut nuk arrin ta plotësojë nevojën për përkthime të kërkuara nga stacionet nën komandën e vet. Problemi i gjuhës ndikon në efikasitetin e policisë dhe rezultojnë në keqkuptime mes policisë dhe qytetarëve;
- Policia e Kosovës ka një numër të zyrtarëve jo-kompetent në strukturat e saj në komunat me shumicë serbe. Kjo vjen si rezultat i procesit të lehtësuar të gradimit të pakicave etnike dhe i procedurës së përsheptuar të verifikimit të sigurisë dhe trajnimit në procesin e integritit të ish-anëtarëve të Ministrisë së Brendshme të Serbisë (MUP);
- Strukturat e Policisë së Kosovës në komunat me shumicë serbe kanë përfaqësim të dobët gjinor; vetëm 10.9% të oficerëve të policisë në Mitrovicën e Veriut, Zubin Potok, Zveçan, Leposaviq, Graçanicë dhe Shtërpcë janë gra. Përqindja e përgjithshme e grave që shërbejnë në Policinë e Kosovës në nivel kombëtar është 14.15%.

Hyrje

Integrimi i komuniteteve etnike, në veçanti i komunitetit serb (në vijim komuniteti serb i Kosovës), në Policinë e Kosovës (PK), ka qenë një nga prioritetet kryesore të institucioneve të Kosovës dhe komunitetit ndërkombëtar. Procesi i integrimit filloi menjëherë pas luftës në Kosovë dhe gjatë viteve është përballur me shumë sfida, kryesisht për shkak të rezistencës së komunitetit serb të Kosovës për të njohur autoritetin e PK-së si pjesë legjitime e Shtetit të Kosovës.

Komuniteti serb i Kosovës që jeton në jug të lumit Ibër, filloi ta mbështesë konceptin e policimit nga këndvështrimi i komunitetit dhe si një instrument i shërbimit publik. Ndërsa në Veri¹, deri në shpërbërjen e strukturave paralele të sigurisë si rezultat i Marrëveshjes së Brukselit në vitin 2013, mbizotëronte trashëgimia e sistemit të mëparshëm të policimit të bazuar në militarizim dhe interesat e shtetit serb. Kjo ka sjellë perceptime të përziera ndaj PK-së në katër komunat veriore. Edhe pse shumë prej anëtarëve serb të PK-së vijnë nga ish MUP-i i Serbisë, ngurrimi kundrejt PK-së shpërfaqet jo vetëm për shkak të simbolikës që lidhet me uniformën e PK-së, por edhe për shkak të nivelit të kompetencës dhe besnikërinë ndaj interesit të komunitetit. Kjo ide është shprehur nga politikani i njohur serb në pjesë veriore të Kosovës, z. Oliver Ivanović, i cili kishte thënë se të njëjtët persona, të cilët vepronin me kompetencë në MUP-in e Serbisë, nuk po veprojnë në të njëjtin nivel nën uniformën e Kosovës.²

Ky punim përmbledh gjendjen ekzistuese në lidhje me qëndrimin e komunitetit serb të Kosovës kundrejt PK-së në komunat me shumicë serbe, duke u fokusuar në katër komunat veriore të Kosovës. Punimi mbulon kontekstin e ngjarjeve dhe zhvillimeve kryesore, dhe e paraqet perceptimin publik kundrejt PK-së si rezultat të tensioneve politike në veri dhe gjendjes së përgjithshme të frikës në mesin e popullatës. Përveç kësaj, punimi analizon shqetësimet kryesore të sigurisë të komunitetit serb të Kosovës, si dhe ofron disa rekomandime për adresimin e shqetësimeve dhe sfidave të tilla nga këndvështrimi i komunitetit.

Punimi mbështetet në hulumtimet e gjera të ekipit të QKSS-së në veri të Kosovës dhe në komuna kyçe me shumicë serbe në pjesën tjetër të Kosovës. QKSS zhvilloi diskutime të ndara me qytetarë dhe përfaqësues të policisë në gjashtë punëtori në: Mitrovicë të Veriut, Leposaviq, Zveçan, Zubin Potok, Graçanicë dhe Shtërpcë. Këto u pasuan nga intervista ballë për ballë me përfaqësuesit e qeverisë si dhe me shoqërinë civile. Ekipi bëri analizën e përmbajtjes së dokumenteve zyrtare, raporteve ekzistuese dhe shqyrtimeve të kornizave ligjore përkatëse. Gjetjet e përgjithshme janë mbështetur edhe nga përfshirja e ekipit të QKSS në procese të ndryshme relevante, si dhe në konsultimet me aktorët përkatës.

1 Çdo përmendje e Kosovës së Veriut, Komunave Veriore apo thjesht Veriut, u referohet 4 komunave: Mitrovicë e Veriut, Zubin Potok, Zveçan dhe Leposaviq.

2 Për më shumë shihni: <https://www.blic.rs/vesti/politika/oliver-ivanovic-nekoliko-meseci-pre-ubistva-situacija-na-kosovu-se-promenila-na-gore/ce48vdd>

Konteksti historik i marrëdhënieve të komunitetit serb të Kosovës me Policinë e Kosovës

Për të mbushur vakuumin institucional dhe të sigurisë pas luftës së Kosovës të vitit 1999, Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) vendosi një administratë të përkohshme në Kosovë, me autoritet ekzekutiv dhe legjislativ³. Institucionet lokale, si Policia e Kosovës (PK),⁴ filluan të themelohen nën mbikëqyrjen dhe me ndihmën e UNMIK-ut dhe të organizatave të tjera ndërkombëtare dhe gradualisht e morën autoritetin nga administrata ndërkombëtare. Komuniteti serb në Kosovë nuk e njohu menjëherë administratën e UNMIK-ut dhe as përpjekjet ndërkombëtare për krijimin e institucioneve të qëndrueshme multietnike. Serbët e Kosovës arritën të mbajnë struktura paralele në komunat me shumicë serbe, të cilat de facto vepronin nën autoritetin e Qeverisë së Serbisë.⁵ Strukturat paralele përfshinin shkollat, gjykatat dhe kujdesin shëndetësor, ndërkohë që strukturat paralele të sigurisë dhe prania e Ministrisë së Brendshme të Serbisë (MUP) përbënin sfidën më të madhe për administratën e atëhershme.

3 Rregullorja e UNMIK Nr. 1999/1, 25 korrik 1999.

4 Deri në vitin 2008, Policia e Kosovës ishte e njohur si Shërbimi Policor i Kosovës.

5 OSBE (2003). *Strukturat Paralele në Kosovë*. I disponueshëm në: <https://www.osce.org/kosovo/42584?download=true>

Edhe pse këto struktura vepronin ilegalisht, administrata e UNMIK-ut i toleroi për një kohë të gjatë. E njëjta tolerancë u aplikua edhe ndaj aktorëve jo-zyrtar të sigurisë mes shqiptarëve të Kosovës. Ndonëse nuk kishte sqarime zyrtare për qasjen e UNMIK-ut ndaj këtyre strukturave, me gjasë ishin tensionet etnike dhe ndjeshmëria e situatës politike në Kosovë që e motivonin lejimin e këtyre strukturave. Përkundër faktit se këto struktura nuk ekzistojnë më në formën e tyre fillestare, janë disa elemente që vazhdojnë t'i sfidojnë institucionet e Kosovës dhe të ndikojnë në perceptimin e komunitetit serb të Kosovës ndaj tyre. Subjektet kryesore që përbënin strukturat paralele të sigurisë që vepronin në komunat veriore ishin të ashtuquajturit "Rojet e Urës" dhe anëtarët e MUP-it.

"Rojet e Urës" ishin një organizatë e vetëshpallur e sigurisë e formuar në Veri të Kosovës, të cilët mbështeteshin dhe financoheshin nga Serbia. Për shkak të pamundësisë së institucioneve lokale dhe ndërkombëtare për të ushtruar autoritet të plotë në Veri dhe refuzimit të këtyre aktorëve nga ana e komunitetit, "Rojet e Urës" u kthyen në agjencinë kryesore të "zbatimit të ligjit" në këtë zonë nga fundi i vitit 1999 deri në fund të vitit 2001.⁶ Qëllimi i tyre kryesor ishte monitorimi i situatës mbi urë dhe rezistenca ndaj çdo organizimi ad hoc apo të organizuar të shqiptarëve të Kosovës për të hyrë në veri të Kosovës. Në fillim të vitit 2003, Rojet e Urës filluan ta humbasin mbështetjen politike dhe financiare nga Beogradi për shkak të mosmarrëveshjeve të Serbisë me përfaqësuesit politikë nga komuniteti i serbëve të Kosovës, dhe falë një përpjekjeje të pretenduar për rekrutimin e anëtarëve të grupit në Policinë e Kosovës. Në mungesë të mbështetjes politike dhe financiare, ky grup morri një profil të ulët, dhe nuk i ushtroi më "detyrat e zbatimit të ligjit".⁷ Megjithatë, ata arritën t'i mbajnë gjallë disa nga komponentët e tyre deri në vitin 2007, vazhduan të kishin rol në monitorimin e situatës së sigurisë në komunat veriore, dhe ishin të gatshëm të ndërhyjnë kur ishte e nevojshme.⁸ Ndryshe nga Rojtarët e Urës, prania e oficerëve të MUP-it në Veri ishte e vazhdueshme. Anëtarët e MUP-it përbëheshin nga ish oficerët e policisë në Kosovë që kishin qenë aktivë gjatë regjimit të Millosheviçit, si dhe nga oficerë të dërguar nga Serbia për të mbledhur informacione dhe për të ofruar shërbime administrative.⁹ Përveç shërbimeve administrative, ata ishin gjithashtu të angazhuar në aktivitete policore, por për shkak të mos ekspozimit të madh në publik, aktivitetet e tyre nuk ishin plotësisht të qarta. Ndryshe nga "Rojet e Urës", oficerët e MUP-it mbështeteshin në mënyrë të qëndrueshme nga Serbia për të mbajtur një prani të drejtpërdrejtë në Veri. Kjo bëri që zyrtarët e MUP-it në veri ta dëmtojnë rolin e grupeve lokale si "Rojet të Urës"

6 Po aty.

7 Po aty, faqe 14.

8 OSBE (2007). *Strukturat paralele në Kosovë – 2006 – 2008*.

9 Po aty.

në një periudhë kur brenda atyre grupeve filluan të shfaqen ndarje politike. Kjo i lejoi Beogradit të dërgonte një mesazh për popullatën lokale që Serbia ende kishte kontroll mbi zonën.¹⁰

Që nga themelimi i Policisë së Kosovës ka pasur përpjekje të vazhdueshme për të integruar strukturat paralele dhe komunitetin serb të Kosovës në të. Megjithatë, përpjekjet e para për t'i integruar në PK në vitet 2000 - 2003 nuk patën sukses; në vitin 2002, rreth 200 anëtarë të "Rojeve të Urës" dhe oficerë të MUP-it shprehën interesimin e tyre për të hyrë në radhët e PK-së, por vetëm tre aplikantë i plotësuan kriteret. Sidoqoftë, në vitin 2008, kur në PK ishin përfshirë gjithsej 709 anëtarë serbë të Kosovës, procesi i integritit u konsiderua i suksesshëm nga organizatat ndërkombëtare.¹¹

Që nga viti 2008, përfaqësimi i komuniteteve etnike në PK është i garantuar me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe sigurohet me Ligjin Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës dhe Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale. Kushtetuta dhe Ligji për PK-në theksojnë se Policia duhet të pasqyrojë diversitetin etnik të popullatës së Kosovës dhe se zyrtarët policorë të caktuar brenda një komune duhet të pasqyrojnë përbërjen etnike të komunës përkatëse, deri në masën që kjo është e mundur.¹² Ligji për Vetëqeverisjen Lokale u garanton komunave me shumicë serbe të Kosovës të drejtat ekskluzive për të marrë pjesë në procesin e përzgjedhjes së komandantëve të stacioneve policore lokale.¹³ Kjo është bërë në mënyrë që komuniteti serb i Kosovës të sigurohet se PK-ja është një forcë që synon t'u shërbejë të gjithë qytetarëve, pavarësisht nga përkatësia e tyre etnike apo rrethana të tjera.

Përkundër garancive ligjore, pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës, PK-ja u përball me sfida madhore në aspektin e përfaqësimit të komunitetit serb të Kosovës në institucion dhe në veprimtarinë e vet në pjesën veriore të vendit. Në shkurt të vitit 2008, nën presionin e Beogradit, anëtarët serbë të Kosovës të PK-së u dhanë dorëheqje nga pozitat e tyre dhe refuzuan të ndërmarrin detyrat e tyre të përditshme. Ata e kushtëzuan kthimin në pozitat e tyre me lejen që të raportojnë drejtpërdrejt në UNMIK. Për shkak të fleksibilitetit dhe dëshirës së PK-së për integrim të qëndrueshëm të

10 Grupi Ndërkombëtar i Krizave (2005), *Zgjidhje për Mitrovicën, Jo ndarje të Kosovës*. I disponueshëm në: <https://d2071andvip0wj.cloudfront.net/Bridging%20Kosovo's%20Mitrovica%20Divide.pdf>

11 M. G., J. F., & R. B. (2012). *Ndërtimi i shërbimit policor në një vakuum të sigurisë: përpjekjet ndërkombëtare në Kosovë, 1999 - 2011*. I disponueshëm në: <https://successfultsociety.princeton.edu/sites/successfultsociety/files/Kosovo%20Police%20ToU.pdf>

12 Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 128/2, 2008, dhe Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës, neni 35, 2012;

13 Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 19.

komunitetit serb të Kosovës, kërkesa e oficerëve të Mitrovicës së Veriut u pranua, duke rezultuar në kthimin në punë të 140 oficerë nën mbikëqyrjen e UNMIK-ut. Megjithatë, kjo nuk u lejua edhe për komunitatet e tjera me shumicë serbe, dhe shumica e anëtarëve serbë të Kosovës të PK-së refuzuan të kthehen në pozitat e tyre.¹⁴ Në përgjigje ndaj refuzimit të tyre, në bashkëpunim me EULEX-in dhe organizatat e tjera ndërkombëtare, PK-ja caktoi qershorin 2009 si afat të fundit për kthimin në pozitat e tyre të oficerëve të dorëhequr të policisë; përndryshe, ata do t'i humbnin përgjithmonë vendet e punës.¹⁵ Falë presionit ndërkombëtar ndaj Beogradit dhe fleksibilitetit të PK-së, afati përfundimtar rezultoi i suksesshëm, dhe shumica e oficerëve serbë të Kosovës u rikthyen në pozitat e tyre deri në datën e caktuar.

Viti 2013 shënoi suksesin më të madh në lidhje me integrimin e komunitetit serb të Kosovës në PK. Kosova dhe Serbia arritën një marrëveshje, e njohur si Marrëveshja e Brukselit e vitit 2013, në të cilën të dy vendet u dakorduan t'i shkrijnë strukturat paralele të financuara dhe të drejtuara nga Serbia dhe t'i integrojnë anëtarët e tyre në institucionet e Kosovës. Neni 7 i marrëveshjes deklaroi se *“Do të ketë një forcë policore në Kosovë, e quajtur Policia e Kosovës. Të gjithë policët në Veri të Kosovës do të integrohen në kornizën e Policisë së Kosovës”* Për më tepër, marrëveshja thekson se do të ketë një Komandant Rajonal të Policisë serbe të Kosovës për komunitatet veriore, i cili emërohet nga Ministria e Punëve të Brendshme e Kosovës me propozimin e kryetarëve të komunave përkatëse.¹⁶ Qeveria serbe ishte përgjegjëse për shpërbërjen e strukturave paralele, pensionimin e personelit të tyre, dhe që t'u siguronte Autoriteteve të Kosovës një listë të oficerëve të MUP-it nga Veriu që do të hynin në radhët e PK-së, e cila më pas ishte përgjegjëse për trajnimin dhe integrimin e këtyre zyrtarëve në PK. Komuniteti ndërkombëtar luajti një rol vendimtar, duke siguruar që procesi i tranzicionit të përfundoj sipas dispozitave të dakorduara.¹⁷ Serbia dorëzoi një listë prej 337 individësh, nga të cilët 285 hynë në radhët e PK-së, dhe përfaqësimi i komunitetit serb të Kosovës arriti nivelin e kënaqshëm prej 11.49% deri në fund të vitit 2013.¹⁸ Procesi i integritit kaloi disa

14 Po aty.

15 D.E. (2014). *Përfshirje apo përjashtim? Pakicat në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pavarur*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Inclusion_or_Exclusion_Minorities_In_The_Security_Sector_In_PostIndependent_Kosovo_223772.pdf

16 Marrëveshja e Brukselit (2013) neni 9. E disponueshme në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/FIRST_AGREEMENT_OF_PRINCIPLES_GOVERNING_THE_NORMALIZATION_OF_RELATIONS,_APRIL_19,_2013_BRUSSELS_en.pdf

17 M.B. & B.E. (2014). *Integrimi i Policisë në Kosovën e Veriut: Progresi dhe sfidat e mbetura në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Police_Integration_in_North_Kosovo_851241.pdf

18 Po aty.

sfida që shkaktuan reagimin e publikut në Kosovë dhe Serbi. Pas përfundimit të procesit, filluan protestat e ish-anëtarëve të MUP-it që i ishin nënshtruar pensionimit të detyruar për shkak të marrëveshjes dhe ishin përjashtuar nga procesi i integritetit, të cilët kërkonin zgjidhjen e statusit të tyre.¹⁹ Përjashtimin e tyre opinioni publik ia atribuoi mos-përmbushjes së kërkesave, mungesës së statusit të tyre si banorë të përhershëm të Kosovës, angazhimit të tyre të mëparshëm në PK, dhe shkarkimit të tyre para marrëveshjes. Sidoqoftë, statusi i tyre mbeti i pazgjidhur. Kritika publike u ngritën rreth trajnimit të shkurtër të anëtarëve të MUP-it, të cilët kaluan një trajnim njëjavor, ndërkohë që trajnimi i rregullt i PK-së zgjat 9 muaj. Për më tepër, janë ngritur pyetje rreth profilit të anëtarëve të MUP-it për shkak të mungesës së informacionit të qartë në lidhje me të kaluarën e tyre, dhe procesit të lehtësuar dhe të përshpejtuar të verifikimit të sigurisë.²⁰

Për të siguruar integritetin e strukturave lokale të PK-së, Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) e ka shtrirë autoritetin e vet në pjesën veriore të vendit me hapjen e zyrës në Mitrovicën e Veriut, pesë vjet më parë. Kjo zyrë pranon dhe shqyrton ankesat e qytetarëve në katër komunat veriore dhe përbëhet nga anëtarë serbë të IPK-së. Nga ana tjetër, në Shtërpcë dhe Graçanicë nuk ka zyrë të IPK-së; megjithatë, qytetarët e tyre mund t'i adresojnë ankesat e tyre në komunat më të afërta, Prishtinë dhe Gjilan përkatësisht.²¹ Duke qenë se IPK-ja nuk ka personel të mjaftueshëm, zyra e Mitrovicës së Veriut nuk punon me kohë të plotë, duke punuar vetëm në ditë të caktuara.²² Komuniteti serb i Kosovës nuk ka edhe aq njohuri për punën e IPK-së në komunat me shumicë serbe të Kosovës, dhe është e nevojshme që IPK-ja të zhvillojë fushata të marrëdhënive me publikun në këtë pjesë të vendit, duke shpjeguar mandatin e institucionit dhe duke promovuar punën e vet. Ky do të ishte një hap i rëndësishëm drejt ndërtimit të besimit në PK.²³

19 Zeri.info (2015). *Ish pjesëtarët e MUP-it serb protestojnë në veri. I disponueshëm në: <https://zeri.info/aktuale/21126/ish-pjesetaret-e-mup-it-serb-protestojne-ne-veri/>*

20 M.B. & B.E. (2014). *Integrimi i Policisë në Kosovën e Veriut: Progresi dhe sfidat e mbetura në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Police_Integration_in_North_Kosovo_851241.pdf.

21 Intervistë me zyrtarin e Inspektoratit Policor të Kosovës. 17/05/2019

22 Intervistë me zyrtarin e Inspektoratit Policor të Kosovës. 12/06/2019

23 Grup fokusi me komunitetin e Zveçanit dhe përfaqësuesit e policisë. Mitrovica e Veriut - 08/04/2019

Ndikimi politik mbi perceptimin e komunitetit serb të Kosovës kundrejt Policisë së Kosovës

Kompleksiteti i rrethanave politike ndërmjet Kosovës dhe Serbisë vazhdon të jetë një nga çështjet kryesore që ndikojnë në qëndrimet e komunitetit serb të Kosovës ndaj institucioneve të Kosovës. Mungesa e vullnetit politik për arritjen e një marrëveshjeje të qëndrueshme mes dy vendeve, ruan hendekun mes komunitetit serb të Kosovës dhe institucioneve të Kosovës, dhe i fsheh çështjet vitale që duhet të adresohen për mirëqenien e komunitetit serb në Kosovë.²⁴ Dallimet politike i kanë lënë PK-në dhe Policinë Serbe pa bashkëpunim zyrtar. Për më tepër, pavarësisht nga një marrëveshje nominale mes Kosovës dhe Serbisë që të mos bllokojnë apo inkurajojnë të tjerët të bllokojnë progresin e njëri tjetrit,²⁵ Serbia - e mbështetur nga Rusia dhe vende të tjera - ndikoi në dështimin e përpjekjes së Kosovës për t'u anëtarësuar në INTERPOL.²⁶ Në të vërtetë, mungesa e bashkëpunimit policor ka çuar drejt kthimit të veriut të Kosovës në terren pjellor për aktivitetet e krimit të organizuar dhe strehë të sigurt për kriminelët nga Kosova dhe Serbia.²⁷

24 Balkan Insight (2018). *Gjuhët: Problemi i Kosovës për të cilin askush nuk flet*. I disponueshëm në: <https://balkaninsight.com/2018/05/04/languages-the-kosovo-problem-nobody-talks-about-04-26-2018/>

25 Marrëveshja e Brukselit (2013). Neni 14

26 Balkan Insight (2018). *Dështon përpjekja e Kosovës për anëtarësim në Interpol*. I disponueshëm në: <https://balkaninsight.com/2018/11/20/kosovo-s-bid-to-join-interpol-fails-11-20-2018/>

27 Intervistë me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile nga Mitrovica e Veriut

Për më tepër, dëshmitë tregojnë se ish-anëtarët e strukturave paralele, të cilët tashmë janë në qendër të vëmendjes kur bëhet fjalë për krimin e organizuar në këtë zonë, kanë lidhje të ngushta me strukturat e PK-së në Veri dhe politikanët nga të dy vendet. Rrjedhimisht, komuniteti serb i Kosovës në Veri sheh segmente të caktuara të PK-së si të lidhura në thelb me korrupsionin dhe strukturat kriminale lokale, dhe ngurren të bashkëpunojë dhe të njohë autoritetin e tyre.²⁸

Edhe pse vitet e fundit komuniteti serb i Kosovës është përshtatur me praninë e PK-së në Veri, ata vazhdojnë të jenë skeptikë ndaj njësive speciale të PK-së që veprojnë në zonë. Subjekte të caktuara politike në Serbi dhe përfaqësuesit politikë të komunitetit serb në Kosovë tentojnë t'i portretizojnë operacionet e PK-së në Veri si shtypje e komunitetit serb të Kosovës, dhe i inkurajojnë qytetarët që të rezistojnë. Për më tepër, në çdo ndërhyrje të njësive speciale të PK-së në Veri, sirenat e mbrojtjes civile ndizen me qëllim mobilizimin e komunitetit, mbjelljen e frikës dhe potencialisht përshkallëzimin e situatës. Kjo qasje ushqen ndjenjat e pasigurisë mes komunitetit dhe delegjitimon përpjekjet e PK-së në luftën kundër krimin të organizuar në Veri. Rrjedhimisht, vizita e Presidentit të Kosovës në Zubin Potok më 29 shtator 2018 u konsiderua si provokim, dhe prania e njësive speciale të PK-së që shoqëronin delegacionin u perceptua si kërcënim nga komuniteti.²⁹ Ka pasur edhe protesta dhe përpjekje për të ndaluar ndërhyrjen e PK-së dhe Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK) në veri dhe arrestimin e oficerëve të PK-së të dyshuar për korrupsion, pavarësisht qëllimit pozitiv dhe përfitimeve që do të kishte komuniteti serb i Kosovës nga operacione të tilla. Qytetarët nga Veriu besojnë se çështjet e policisë në këtë pjesë të vendit duhet të zgjidhen në nivel lokal nga policia me shumicë serbe, dhe përfshirjen e njësive speciale në çështje të tilla e konsiderojnë si ekzagjerim dhe pjesë të lojërave politike.³⁰

Nga ana tjetër, njësitë e ndryshme të PK-së janë më të mirëpritura në komunitat me shumicë serbe në Jug. Në maj të vitit 2019, njësitë speciale të PK-së ndërhyjnë në Shtërpcë për të ndaluar një protestë të paautorizuar, duke shkaktuar përplasje mes protestuesve dhe policisë.³¹ Pavarësisht përdorimit të gjerë të forcës dhe përpjekjes së Serbisë për ta politizuar operacionin, ndërmjet përfaqësuesve të protestës, PK-së dhe komunës së Shtërpcës u arrit marrëveshja që të zhvillohej një takim për të diskutuar dhe adresuar shqetësimet e qytetarëve.³²

28 Intervistë me Përfaqësuesin e Mediave nga Prishtina

29 Grup fokusi me komunitetin e Zubin Potokut dhe përfaqësuesit e policisë. Zubin Potok – 26/10/2018

30 Grup fokusi me komunitetin e Mitrovicës së Veriut dhe përfaqësuesit e policisë. Mitrovica e Veriut - 05/12/2018

31 Kallxo.com (2019). *Eskaloni proteste kundër hidrocentralit në Shtërpcë*. I disponueshëm në: <https://kallxo.com/eskalon-protesta-kunder-hidrocentralit-ne-shterpce/>

32 Kallxo.com (2019). *Protesta në Shtërpcë, Policia përdor shtypje për t'i shpërndarë protestuesit*. I disponueshëm në: <https://kallxo.com/protesta-ne-shterpce-policia-perdor-shtypje-per-ti-shperndare-protestuesit/>

Veriu i Kosovës ka qenë subjekt i shumë sulmeve të pazgjidhura kundër figurave politike dhe zyrtarëve serbë të institucioneve të Kosovës, duke ngritur shqetësime në lidhje me aftësinë e policisë për ta ushtruar plotësisht autoritetin e vet në këtë pjesë të vendit. Rasti i fundit i pazgjidhur është vrasja e Oliver Ivanoviq, një politikan i njohur serb nga Mitrovica e Veriut. Vrasjes së tij i paraprinë tre sulme me bomba mbi pronën e tij personale dhe selinë e partisë që ai përfaqësonte. Në një intervistë me z. Ivanoviq, në të cilin paralajmëronte me humor për mundësinë e vrasjes së tij, përmendet emri i Milan Radojiçiq si figurë kyçe për aktivitetet e krimit të organizuar dhe si udhëheqës i një “qendre informale të pushtetit” në Veri.³³ Dysohet se Milan Radojiçiq, nënkryetari i partisë së serbëve të Kosovës “Lista Srpska”, është organizatori i shumë sulmeve politike në veri dhe bashkëpunon ngushtë me figura të diskutueshme si Zvonko Veselinoviq³⁴, i cili konsiderohet të jetë partneri i tij i biznesit në aktivitetet e tyre të ligjshme dhe të paligjshme. Pavarësisht vetë-deklarimit të tyre si mbrojtës të interesave të serbëve të Kosovës dhe narrativës së tyre nacionaliste, Milan Radojiçiq dhe Zvonko Veselinoviq nuk kanë pengesa kur flitet për bashkëpunimin me kriminelë shqiptarë, ndaj të cilëve janë ngritur aktakuza për disa vepra penale. Zvonko Veselinoviq ka qenë i angazhuar në mënyrë aktive në kontrabandën e derivateve, së bashku me një grup kriminal të shqiptarëve të Kosovës, që e ndihmonin në shpërndarjen e derivateve të kontrabanduara në të gjithë Kosovën.³⁵ Për më tepër, thuhet se një kompani ndërtimi në pronësi të Radojiçiq dhe Veselinoviq është një nga nënkontraktorët në ndërtimin e autostradës “Ibrahim Rugova”, e cila lidh Kosovën dhe Shqipërinë. Ironikisht, mendohet se kamionët e së njëjtës kompani janë përdorur si barriera gjatë “Krizës së Barrierave” në Veri.³⁶

Edhe pse kishte prova që tregonin lidhjet e Milan Radojiçiqit me krimin e organizuar edhe para vrasjes së z. Ivanovic, autoritetet e Kosovës kanë ndihmuar në legjitimimin e tij si përfaqësues politik të serbëve të Kosovës. Kryeministri i Kosovës, z. Ramush Haradinaj, ka pasur disa takime me të pasi Radojiçiq, si zëvendëskryetar i “Lista Srpska”, është partner i koalicionit në qeverinë Haradinaj. Pasi u kritikua për takimin me Milan Radojiçiq, kryeministri Haradinaj deklaroi se edhe krerët e tjerë

33 Balkan Insight (2018). *Ivanoviq e përmendi Radojiçiqin si Sundimtarin e Errët të Kosovës së Veriut*. I disponueshëm në: <https://balkaninsight.com/2018/02/27/ivanovic-named-radoicic-as-north-kosovo-dark-ruler-02-26-2018/>

34 Për më shumë mbi profilin e Zvonko Veselinoviqit dhe lidhjet e tij me krimin e organizuar dhe politikanët në Serbi ju lutemi lexoni: <https://www.krik.rs/en/serbian-presidents-brother-met-infamous-criminal/>

35 Balkan Insight (2012). *Kontrabandistët e naftës në Kosovë të ndaluar për një muaj*. I disponueshëm në: <https://balkaninsight.com/2012/06/01/kosovo-petrol-smugglers-ordered-month-in-detention/>

36 Iniciativa Globale Kundër Krimit të Organizuar Transnacional (2019). *Pikat e nxehta të Krimit të Organizuar në Ballkanin Perëndimor*. I disponueshëm në: <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-English-13Jun1110-Web.pdf>

politikë kishin bashkëpunuar me të, duke theksuar një takim të përbashkët mes Haradinajt, Presidentit të Kosovës z. Hashim Thaçit dhe Milan Radojiçit në zyrën e Presidentit.³⁷ Më vonë, hetimet e PK-së për vrasjen e Ivanoviqit çonin drejt Milan Radojiçit dhe grupit të tij si të dyshuarit kryesorë. Si rezultat, PK-ja filloi një operacion në shkallë të gjerë për zgjidhjen e vrasjes së Ivanoviqit, dhe arriti të arrestojë katër të dyshuar, nga të cilët dy ishin pjesëtarë të PK-së. Megjithatë, nuk u arrit të arrestohej i dyshuari kryesor, Milan Radojiç.³⁸ Pavarësisht lidhjeve të tij të dukshme me krimin e organizuar dhe vrasjen e z. Ivanoviq, Serbia nuk ngurroi ta strehojë z. Radojiç dhe të refuzojë bashkëpunimin me autoritetet e Kosovës për zgjidhjen e rastit Ivanoviq. Përveç ndihmës në ikjen e Radojiçit nga autoritetet e Kosovës, presidenti serb Aleksandër Vuçiq vazhdon të jetë i zëshëm në mbrojtje të Milan Radojiçit. Z. Vuçiq deklaroi se informacioni që posedon Serbia nuk e lidh Radojiçin në asnjë mënyrë me vrasjen e Oliver Ivanoviqit, dhe se autoritetet e Kosovës po i fshehin faktet që tregojnë vrasësin e tij të vërtetë.³⁹ Qasja e Serbisë ndaj këtij rasti e ka shqetësuar komunitetin serb të Kosovës, të cilët shprehen skeptikë në lidhje me zgjidhjen e rastit Ivanoviq. Pavarësisht kritikave të tyre ndaj qasjes operationale të PK-së, ata i mirëpritën arrestimet; sidoqoftë, ekziston një ndjenjë e përgjithshme se i dyshuari kryesor do të amnistohet dhe do ta vazhdojë lirshëm aktivitetin kriminal në Veri, për shkak të lidhjeve të forta politike në të dy vendet.⁴⁰

Beogradi ka bërë përpjekje të vazhdueshme që t'i zvogëlojë arritjet e integritit në institucionet e Kosovës, duke përdorur masa agresive si kërcënimet fizike dhe shantazhet. Në vitin 2018, Serbia u bë e dhunshme kundër Forcës së Sigurisë së Kosovës (FSK), duke çuar në dorëheqjen e pothuajse 50% të pjesëtarëve serbë të Kosovës nga FSK-ja.⁴¹ Gjatë kësaj fushate agresive, kushdo që mbështeti publikisht dorëheqjen e anëtarëve të FSK-së dhe denoncoi qasjen e Serbisë, u stigmatizua politikisht për shkak të perceptimit si "tradhtarë".⁴² Rrjedhimisht, pavarësisht shqetësimeve

37 Kallxo.com (2019). *Haradinaj zbardh takimin e Hashim Thaçit me Milan Radojiçin*. I disponueshëm në: <https://kallxo.com/haradinaj-zbardh-takimin-e-hashim-thacit-me-milan-radojicqin/>

38 Balkan Insight (2018). *Vrasja e Oliver Ivanoviqit: Arrestimet e kryera deri më tani*. I disponueshëm në: <http://archive.balkaninsight.com/al/article/vrasja-e-oliver-ivanovi%C3%A7it-arrestimet-e-kryera-deri-m%C3%AB-tani-11-27-2018>
Ka raportime joformale që tregojnë se Radojiç mund të jetë paralajmëruar për bastisjen e policisë pak orë më herët, nga disa elemente në Qeverinë e Kosovës.

39 Radio Slobodna Evropa (2019). *Vuçi: Mislmo da imamo ime ubice Olivera Ivanovića*. I disponueshëm në: <https://www.slobodnaevropa.org/a/30034800.html>

40 Grup fokusi me komunitetin e Mitrovicës së Veriut dhe përfaqësuesit e policisë. Mitrovica e Veriut - 05/12/2018

41 S.H.B. & T.B. (2018). *Tendenat e shkatërrimit të multietnicitetit: Dorëheqjet masive të anëtarëve serbë nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe roli i Serbisë*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Policy_brief_eng_434386.pdf

42 Po aty.

të tyre, komuniteti serb i Kosovës ngurron t'i shprehë lirshëm mendimet e veta për rastin Ivanović ose raste të tjera politike, për shkak të frikës nga hakmarrja e mundshme. Për më tepër, Serbia ka imponuar ndarjen mes serbëve të Kosovës të veriut dhe serbëve të Kosovës në jug, duke sjellë qëndrime të ndryshme politike ndaj institucioneve të Kosovës brenda komunitetit. Përfaqësuesit e komunitetit serb të Kosovës theksojnë se serbët në Veri janë më të privilegjuar nga politika në Serbi; domethënë, partia në pushtet në Serbi ka lidhje politike dhe kriminale në pjesën veriore të vendit dhe qasje më të lehtë për ndërhyrje në punët e brendshme të Kosovës atje.⁴³ Përveç kësaj, përfaqësuesit e shoqërisë civile serbe theksojnë se përveç ndarjeve gjeografike, Beogradi po i ndan serbët e Kosovës në serbë "besnikë" dhe "tradhtarë"⁴⁴, duke i detyruar të mos bashkëpunojnë me institucionet e Kosovës për shkak të frikës së një kërcënimi të institucionalizuar nga Serbia dhe një pozite të pafavorshme brenda komunitetit serb në Kosovë.

Arrestimi i anëtarëve të PK-së si pjesë e grupit kriminal të Radojiçiqit ka vënë në pah ndikimin e mundshëm që mund të ketë krimi i organizuar në strukturat e PK-së në Veri. Për më tepër, hulumtimet kanë treguar parregullsi në procesin e ndarjes së gradave për pakicat etnike në Kosovë kur ata konsiderohen për punësim në PK. Për hir të një force multietnike, PK-ja ka ulur standardet e gradimit për anëtarët e pakicave, duke rezultuar në zyrtarë jo-kompetent në pozita të caktuara.⁴⁵ Si rezultat, PK-ja ka vështirësi në caktimin e disa detyrave për disa nga anëtarët e vet për shkak të mungesës së profesionalizmit, duke e dëmtuar kështu efikasitetin e vet dhe perceptimin e publikut.⁴⁶ Shmangia e kontrolleve të duhura të sigurisë për anëtarët e ish MUP-it të integruar në PK, përfshirja e zyrtarëve të PK-së në aktivitetet e krimit të organizuar, dhe lehtësimi i procedurave të gradimit për disa anëtarë të PK-së, kanë rezultuar në performancë të ulët të strukturave të PK-së në veri në aspektin e luftimit të krimit të organizuar. PK-ja duhet të jetë e pakompromis kur flitet për denoncimin e ndikimit politik në strukturat e veta lokale dhe luftën kundër krimit të organizuar. Pavarësisht sfidave, PK-ja duhet të sigurohet që siguria dhe mirëqenia publike të qytetarëve të Kosovës të mos jenë çështje politike, dhe që t'i ketë kapacitetet për adresimin e nevojave dhe shqetësimeve të tyre.

43 REL (2019). *Thellimi i ndarjeve të serbëve në Kosovë nga Beogradi*. I disponueshëm në: <https://www.evropaelire.org/a/ndarje-serbe-te-kosoves-beograd-/30027557.html?nocache=1>

44 Po aty.

45 P.A. (2017). *Monitorimi dhe vlerësimi i integritetit në sektorin e sigurisë*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Monitorimi_dhe_vleresimi_i_integritetit_ne_sektorin_i_sigurise_804909.pdf

46 Intervistë me Përfaqësuesin e Mediave nga Prishtina.

Shqetësimet kryesore të sigurisë të komunitetit Serb në Kosovë

PK-ja ka një nivel të kënaqshëm të përfaqësimit të komunitetit serb të Kosovës, me 12.2% të anëtarëve të vet që vijnë nga ky komunitet. Ndërkohë që integrimi në PK i qytetarëve serbë të Kosovës ka qenë i suksesshëm nga ana statistikore, ai nuk pasqyron të njëjtin sukses sa u përket perceptimeve dhe marrëdhënieve publike ndërmjet PK-së dhe komunitetit serb të Kosovës. Procesi i integritit të komunitetit serb në PK ishte temë e dialogut Kosovë-Serbi, dhe si i tillë, është shmangur një dialog lokal me komunitetin serb në Kosovë mbi përfitimet dhe sfidat e përfshirjes në polici. Prandaj, pavarësisht ngurrimeve, shumica e tyre u inkua-druan në PK vetëm pasi u udhëzuan nga Beogradi që ta bënin këtë.

Për shumicën dërmuese të qytetarëve, Policia e Kosovës (PK) perceptohet si një nga institucionet më të besueshme në Kosovë. Nga ana tjetër, komuniteti serb i Kosovës vazhdon të ketë perceptime negative ndaj policisë, me vetëm 4.7% prej tyre që kanë besim tek PK-ja.⁴⁷

Shqiptarë të Kosovës

65.9%

Serbë të Kosovës

4.7%


Të tjerë

73.9%

Besimi ndaj Policisë së Kosovës sipas përkatësisë etnike.

47 D.M. (2018). *Edicioni i 8^{te} i Barometrit Kosovar të Sigurisë. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2018-SHQIP_853983.pdf*

Barometri Kosovar i Sigurisë (BKS) shqyrton lidhjen mes marrëdhënieve ndëretnike dhe besimit ndaj institucioneve të sigurisë në Kosovë. Edicioni i tetë i BKS-së vuri në dukje se niveli i besimit ndaj PK-së nga komunitetet e ndryshme etnike përcaktohet kryesisht nga pozita e përgjithshme e secilit grup në jetën shoqërore, politike dhe publike. Si rezultat, ka një dallim të theksuar në besimin ndaj PK-së sipas rajoneve. Për shembull, qytetarët e Mitrovicës së Veriut kanë një nivel shumë të ulët besimi kur krahasohen me rajonet e tjera në Kosovë.



Besimi ndaj Policisë së Kosovës sipas Rajoneve.

Komuniteti serb i Kosovës është gjithashtu skeptik në lidhje me integritetin e PK-së. Ndërkohë që shumica e qytetarëve e percepton gjyqësorin dhe Prokurorinë e Shtetit si institucionet më të korruptuara në Kosovë, komuniteti serb i Kosovës e rendit PK-në si institucionin më të korruptuar në vend.⁴⁸



Perceptimi për korrupsionin në Policinë e Kosovës sipas përkatësisë etnike.

Për më tepër, 54.1% e të anketuarve serbë pohojnë se oficerët e policisë nga stacioni më i afërt policor janë të korruptuar.⁴⁹ Përkundër faktit që stacionet policore në komunat me shumicë serbe janë të përbëra nga zyrtarë serbë, komuniteti serb i Kosovës ngurron t'u besoj, dhe i lidh disa nga segmentet e PK-së me aktivitete negative që dëmtojnë perceptimet e integritetit të PK-së. Gjatë tre viteve të fundit, BKS-ja ka matur edhe nëse qytetarët serbë të Kosovës ndihen të sigurt në shtëpitë, lagjet, fshatrat/qytetet e tyre dhe në Kosovë në përgjithësi. Përgjigjet pasqyrojnë mungesën e besimit ndaj institucioneve përgjegjëse për sigurinë e tyre publike. Rezultatet tregojnë se serbët ndihen të sigurt në shtëpitë dhe lagjet e tyre, por nuk ndihen të sigurt në Kosovë në përgjithësi⁵⁰.

48 P.A. (2019). *Edicioni i Posaçëm i Barometrit Kosovar të Sigurisë - Korrupsioni, Sundimi i Ligjit dhe Integriteti Policor në Kosovë*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Corruption_Rule_of_Law_ENG_Final_320893.pdf

49 Po aty.

50 D.M. (2019). *Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i posaçëm për Sigurinë Publike*



Ndërkohë që supozohet se shumica e problemeve të komunitetit serb të Kosovës janë të një natyre etnike, janë të shumta sfida me të cilat përballet ky komunitet dhe që ndikojnë në sigurinë publike. Disa nga shqetësimet kryesore të sigurisë të komunitetit serb të Kosovës dhe të strukturave lokale të PK-së janë mungesa e mjeteve teknike, keqinformimi për punën e PK-së dhe institucioneve tjera, përfaqësimi i dobët gjinor në strukturat lokale të policisë, komunikimi i dobët ndërmjet PK-së dhe institucioneve të tjera, infrastruktura e dobët, dhuna në familje, etj.

Themelimi i Drejtorisë Rajonale të Policisë në Mitrovicën e Veriut u përcaktua nga marrëveshja mes Kosovës dhe Serbisë. Pas themelimit të saj, fokusi i institucioneve të Kosovës ishte menaxhimi i duhur i burimeve njerëzore, ndërtimi i kapaciteteve, si dhe kalimi i kujdesshëm i disa stacioneve policore nga komanda e drejtorisë rajonale të Mitrovicës së Jugut në drejtorinë e Mitrovicës së Veriut. Andaj, pajisja e drejtorisë së Mitrovicës së Veriut me pajisjet e nevojshme nuk ishte prioritet i strukturave qendrore të PK-së, me ç'rast u neglizhuan nevojat për më shumë burime teknike. Nga takimet mes qytetarëve dhe strukturave të PK-së në komunat me shumicë serbe, kemi konstatuar se strukturat lokale të PK-së do të ishin më efikase nëse do t'u siguroheshin burime teknike shtesë. Përfaqësuesit e PK-së nga këto komuna kanë deklaruar se nuk kanë automjete të mjaftueshme për patrullim të duhur dhe për të qenë më të dukshëm në çdo skaj të juridiksionit të tyre territorial.⁵¹ Përveç kësaj, nga komunat e tyre policia ka kërkuar përmirësimin e infrastrukturës, shenja shtesë të trafikut, policë të shtrirë, etj. Përfaqësuesit komunalë kanë deklaruar se shumica e problemeve të infrastrukturës të identifikuara nga policia nuk janë nën juridiksionin e tyre, dhe se kërkesat e adresuara institucioneve relevante kanë rënë në veshë të shurdhër.⁵²

51 Grup fokusi me komunitetin e Zubin Potokut dhe përfaqësuesit e policisë. Zubin Potok – 26/10/2018

52 Grup fokusi me komunitetin e Graçanicës dhe përfaqësuesit e policisë. Graçanicë – 26/02/2019

Reagimet e qytetarëve tregojnë se komuniteti serb i Kosovës nuk ka informacion të mjaftueshëm për funksionimin e PK-së në nivel qendror, të drejtat e tyre, dhe mekanizmat e tjerë ekzistues të sigurisë. Një prej shqetësimeve të tyre kryesore në lidhje me komunikimin e informacionit është përdorimi i dobët i gjuhës serbe në dokumentet zyrtare. Për shkak të përkthimit të gabuar në gjuhën serbe, përmbajtja e shumë dokumenteve të PK-së ndryshon nga versionet shqip dhe anglisht. Mospërputhjet mes versioneve të ndryshme të këtyre dokumenteve kanë çuar në keqkuptime mes qytetarëve dhe policisë.⁵³ Drejtoria e Mitrovicës së Veriut ka vetëm një (1) përkthyes të disponueshëm, dhe për shkak të kërkesës së lartë për përkthim të dokumenteve, përkthyesi nuk ka qenë në gjendje ta menaxhojë me sukses ngarkesën e punës.⁵⁴ Për më tepër, barriera gjuhësore është ndonjëherë pengesë që drejtoria e Mitrovicës së Veriut t'i plotësojë në kohë detyrat e caktuara nga Drejtoria e Përgjithshme, duke rezultuar në vlerësime të dobëta të efikasitetit të tyre.⁵⁵ Sidoqoftë, përkthimi është një problem i përbashkët i të gjitha drejtorive rajonale të PK-së. Edhe pse shumica e stacioneve policore në Kosovë kanë asistentë gjuhësorë, PK-ja e ka reduktuar numrin e përkthyesve në Drejtoritë Rajonale, nga 18 në vitin 2015 në 15 në vitin 2017. I njëjti problem është i pranishëm edhe në institucionet e tjera. Një hulumtim i kryer në vitin 2014 nxjerr në pah gabime të shumfishta në dokumente vendimtare, të tilla si Kushtetuta e Kosovës, Kodi Penal dhe, për ironi, edhe në versionin serb të ligjit për gjuhët.⁵⁶ Përfaqësuesit e shoqërisë civile serbe nga Kosova kanë rekomanduar disa veprime për ta adresuar këtë problem. Sipas tyre, Kuvendi i Kosovës duhet të miratojë një rregullore të jashtëzakonshme që do të lejonte korrigjimin e ligjeve ekzistuese. Ata inkurajojnë qeverinë të krijojë një shërbim qendror të përkthimit, duke imbledhur të gjithë përkthyesit në një zyrë të centralizuar dhe duke koordinuar ngarkesën e punës për t'iu përgjigjur në mënyrë më efektive nevojave të institucioneve si PK-ja.⁵⁷

Përfaqësuesit e policisë deklaruan se i qëndrojnë pranë komunitetit dhe bashkëpunojnë me të; sidoqoftë, ata lodhen nga kërkesat për ndërhyrje në çështje jashtë juridiksionit të tyre, për shkak të keqinformimit të qytetarëve për punën e PK-së.⁵⁸ Ata shërbejnë si urë ndërmjet institucioneve

53 Po aty.

54 OSBE (2018). *Raport Tematik mbi Pajtueshmërinë me Gjuhët në Policinë e Kosovës*. I disponueshëm në: <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/396824?download=true>

55 Po aty.

56 Prishtina Insight (2016). *Kosova, e humbur në përkthim*. I disponueshëm në: <https://prishtinainsight.com/kosovo-lost-translation/>

57 OJQ Aktiv dhe CPT (2016). *Cilësia e përkthimit të ligjeve të Kosovës në gjuhën serbe*. I disponueshëm në: <http://ngoaktiv.org/uploads/files/Policy%20Brief%20-%20Quality%20of%20Translation%20of%20Kosovo%20Laws%20into%20Serbian%20Language.pdf>

58 Grup fokusi me komunitetin e Zveçanit dhe përfaqësuesit e policisë. Mitrovica e Veriut - 08/04/2019

të tjera dhe komunitetit, dhe imazhi i tyre dëmtohet kur këto institucione nuk u përgjigjen kërkesave të qytetarëve.⁵⁹ I njëjti problem është i pranishëm edhe në komunat me shumicë të serbëve të Kosovës në jug.⁶⁰ Stacioni policor në Graçanicë nuk ka person përgjegjës për marrëdhëniet me median; prandaj, ata hasin probleme me konsistencën e komunikimit të mesazheve të tyre për qytetarët.⁶¹ Për më tepër, njësoj si në të gjitha komunat e Kosovës, shqetësimet kryesore drejtëshin edhe ndaj Prokurorisë së Shtetit. Prokuroria nuk i përditëson stacionet lokale të policisë për kallëzimet penale që ata i kanë raportuar, dhe ka shumë raste kur qytetarët që kanë kryer krime në këto komuna mbeten të lirë, duke dëmtuar kështu besimin ndaj PK-së.⁶²

Përfaqësimi gjinor në PK është renditur në mesin e sfidave kryesore nga komuniteti serb i Kosovës. Ndërkohë që ky problem është i pranishëm në të gjitha strukturat e policisë, është gjithashtu i theksuar edhe në komunat me shumicë serbe të Kosovës. Drejtoria rajonale i PK-së në Mitrovicën e Veriut ka 125 oficerë policie, prej të cilëve 13 janë gra; stacioni policor i PK-së në Zubin Potok ka 61 oficerë policie, prej të cilëve 5 janë gra; stacioni policor i PK-së në Leposaviq ka 99 oficerë policie, prej të cilëve 14 janë gra; stacioni policor i PK-së në Zveçan ka 60 oficerë policie, prej të cilëve 5 janë gra; stacioni policor i PK-së në Graçanicë ka 42 oficerë policie, prej të cilëve 5 janë gra; stacioni policor i PK-së në Shtërpçë ka 61 oficerë policie, prej të cilëve 7 janë gra⁶³. Ndërkohë që komuniteti serb e percepton përfaqësimin e dobët gjinor si problem madhor, strukturat e policisë lokale nuk mund të bëjnë shumëçka në këtë drejtim⁶⁴. Ka nevojë për më shumë punë nga niveli qendror i PK-së për t'i inkurajuar gratë nga komuniteti serb i Kosovës që të inkuadrohen në polici dhe, në këtë formë, të ndikohet pozitivisht perceptimi i tyre ndaj PK-së.

59 Po aty.

60 Çdo përmendje e Kosovës së Jugut, Komunave Jugore apo thjesht Jugut, u referohet 2 komunave: Graçanicës dhe Shtërpçës.

61 Grup fokusi me komunitetin e Graçanicës dhe përfaqësuesit e policisë. Graçanicë – 26/02/2019

62 Grup fokusi me komunitetin e Leposaviqit dhe përfaqësuesit e policisë. Leposaviq – 24/01/2019

63 Të dhënat për përbërjen e PK-së në komunat me shumicë serbe janë marrë nga profilet komunale të OSBE 2018.

64 Grup fokusi me komunitetin e Zubin Potokut dhe përfaqësuesit e policisë. Zubin Potok – 26/10/2018

Dhuna në familje është problem madhor në Kosovë, i cili gjithashtu shqetëson komunitetin serb të Kosovës. Qytetarët e këtij komuniteti konsiderojnë se rritja e numrit të oficerëve gra të policisë do të kontribuonte në trajtimin adekuat të viktimave të dhunës në familje dhe do të rriste shkallën e raportimit të dhunës në familje në komunat me shumicë serbe.⁶⁵ PK-ja është organi përgjegjës për sigurimin e masave mbrojtëse për viktimat e dhunës në familje dhe, nëse është e nevojshme, është e detyruar me ligj t'i shoqërojë viktimat e dhunës në familje në institucione të tjera, siç janë strehimoret.⁶⁶ Aktualisht janë 8 qendra të licencuara që ofrojnë strehim për viktimat e dhunës në familje në Kosovë. Strehimoret ndodhen në Gjilan, Prishtinë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Mitrovicë të Jugut, Ferizaj dhe Novobërdë.⁶⁷ Aktualisht nuk ka strehimore që veprojnë në komunat me shumicë serbe, ndërsa strehimorja e Novobërdës është nën menaxhimin e zyrtarëve serbë të Kosovës. Megjithatë, shumica e punëtorëve socialë nga komuniteti serb i Kosovës të angazhuar në këtë strehimore i kanë fituar kredencialet e tyre profesionale në Serbi, dhe si të tillë nuk kishin të drejtë të vazhdonin punën e tyre. Si rezultat, strehimorja nuk e mori ri-licencimin, dhe aktualisht nuk është aktive.⁶⁸

Pavarësisht nga sfidat, integrimi në PK i komunitetit serb të Kosovës duhet të jetë një proces i vazhdueshëm. PK-ja duhet ta bazojë këtë proces në nevojat dhe sfidat e komunitetit serb të Kosovës, dhe t'u sigurojë anëtarëve të tij përfaqësim të duhur dhe vëmendje ndaj shqetësimeve të tyre të sigurisë. PK-ja dhe mekanizmat e tjerë lokalë të sigurisë duhet të ndërmarrin aktivitete të ndryshme për t'i bërë mandatet dhe punën e tyre të qarta për komunitetin serb të Kosovës. Duke vepruar kështu, ata do t'i afrohen komunitetit, do të inkurajojnë bashkëpunimin, dhe do të promovojnë tolerancën dhe përfshirjen.

65 Grupi fokus i me komunitetin e Mitrovicës së Veriut dhe përfaqësuesit e policisë. Mitrovica e Veriut - 05/12/2018

66 Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje. I disponueshëm në: <http://www.assembly-kosova.org/common/docs/ligjet/2010-182-eng.pdf>

67 OSBE (2018). *Raportimi i Dhunës në Familje*. I disponueshëm në: <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/404351?download=true>

68 Po aty.

Rekomandime

- Qeveria e Kosovës duhet të punojë për uljen e ndërhyrjes politike në marrëdhëniet e komunitetit serb të Kosovës me Policinë e Kosovës. Komuniteti ndërkombëtar duhet t'i mbështesë fuqimisht iniciativat e tilla dhe të ndihmojë nëse është e nevojshme;
- Policia e Kosovës duhet të ndërmarrë fushata për të promovuar punën e vet dhe përfshirjen e komunitetit serb të Kosovës. Fushatat e tilla duhet ta bëjnë të qartë se Policia e Kosovës është një forcë e unifikuar, dhe se prania e cilësdo prej njësive të veta në komunat me shumicë serbe ka për qëllim të forcojë sigurinë e qytetarëve;
- Policia e Kosovës duhet të realizojë fushata informuese për të rritur angazhimin e grave në këtë institucion dhe për të rritur numrin e oficerëve gra të policisë në komunat me shumicë serbe;
- Policia e Kosovës duhet të vlerësojë dhe adresojë nevojat për mjete teknike në Drejtorinë Rajonale të Mitrovicës së Veriut;
- Për t'iu përgjigjur më efektivisht kërkesave të stacioneve policore në veri për përkthimin e dokumenteve zyrtare, Policia e Kosovës duhet të rrisë numrin e përkthyesve në Drejtorinë Rajonale të Mitrovicës së Veriut. Për më tepër, Policia e Kosovës inkurajohet të angazhojë më shumë përkthyes në Drejtorinë e tjera Rajonale gjithashtu;
- Policia e Kosovës duhet të sigurojë të gjitha dokumentet e nevojshme për procesin e gradimit në gjuhët amtare të të gjithë kandidatëve përkatës. Sidoqoftë, nuk duhet të bëhen kompromise kur bëhet fjalë për promovimin e anëtarëve të vet, dhe procesi i gradimit duhet të bazohet në merita;
- Inspektorati Policor i Kosovës duhet ta rrisë praninë e vet në komunat me shumicë serbe, ta promovojë punën e vet, dhe të mbikëqyrë në mënyrë aktive punën e policisë në komunat përkatëse;
- Prokuroria e Shtetit duhet të jetë më efikase dhe transparente kur trajton rastet e raportuara nga strukturat policore në komunat me shumicë serbe;
- Komuniteti i donatorëve, në bashkëpunim me organizatat lokale të shoqërisë civile, duhet t'i mbështesë organizatat lokale me bazë komunitare në komunat me shumicë serbe, të organizojë trajnime dhe aktivitete në këto komuna, si dhe të promovojë përfitimet e përfshirjes së komunitetit serb të Kosovës në institucionet e Kosovës;
- Policia e Kosovës, Organizatat e Shoqërisë Civile dhe Institucionet Lokale dhe Qendrore, duhet të organizojnë takime dhe aktivitete të rregullta me komunitetin serb të Kosovës për të diskutuar zhvillimet e sigurisë në Kosovë.

Bibliografia

Grupet e fokusit dhe intervistat:

- Grup fokusi me komunitetin e Zubin Potokut dhe përfaqësuesit e policisë. Zubin Potok – 26/10/2018
- Grup fokusi me komunitetin e Mitrovicës së Veriut dhe përfaqësuesit e policisë. Mitrovica e Veriut - 05/12/2018
- Grup fokusi me komunitetin e Leposaviqit dhe përfaqësuesit e policisë. Leposaviq– 24/01/2019
- Grup fokusi me komunitetin e Graçanicës dhe përfaqësuesit e policisë. Graçanicë – 26/02/2019
- Grup fokusi me komunitetin e Zveçanit dhe përfaqësuesit e policisë. Mitrovicë e Veriut - 08/04/2019
- Grup fokusi me komunitetin e Shtërpcës dhe përfaqësuesit e policisë. Shtërpcë – 08/05/2019
- Intervistë e drejtpërdrejtë me zyrtarin e Inspektoratit Policor të Kosovës. 17/05/2019
- Intervistë e drejtpërdrejtë me zyrtarin e Inspektoratit Policor të Kosovës. 12/06/2019
- Intervistë me shkrim me Përfaqësuesin e Shoqërisë Civile nga Mitrovica e Veriut. 28/05/2019
- Intervistë me Përfaqësuesin e Mediave nga Prishtina. 16/05/2019

Korniza ligjore:

- Rregullorja e UNMIK-ut Nr. 1999/1, 25 korrik 1999.
- Kushtetuta e Republikës së Kosovës, Neni 128/2.
- Ligji Nr. 04/L-076 për Policinë e Kosovës, neni 35.
- Ligji Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, neni 19
- Ligji Nr. 03/L-182 për Mbrojtjen nga Dhuna në Familje.
- Marrëveshja e Brukselit (2013), nenet 9 dhe 14.

Raporte dhe artikuj të mediave:

- OSBE (2003). *Strukturat Paralele në Kosovë*. I disponueshëm në: <https://www.osce.org/kosovo/42584?download=true>
- Grupi Ndërkombëtar i Krizave (2005) *Zgjidhje për Mitrovicën, Jo ndarje të Kosovës*. I disponueshëm në: <https://d2071andvip0wj.cloudfront.net/Bridging%20Kosovo's%20Mitrovica%20Divide.pdf>
- OSBE (2007). *Strukturat paralele në Kosovë – 2006 – 2008*.
- M.Green, J.Friedman & R.Bennet (2012). *Ndërtimi i shërbimit policor në një vakuum të siguriës: përpjekjet ndërkombëtare në Kosovë, 1999 - 2011*. I disponueshëm në: <https://successfulsocieties.princeton.edu/sites/successfulsocieties/files/Kosovo%20Police%20ToU.pdf>
- D. Emini (2014). *Përfshirje apo përjashtim? Pakicat në Sektorin e Sigurisë në Kosovën e Pavarur*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Inclusion_or_Exclusion_Minorities_In_The_Security_Sector_In_PostIndependent_Kosovo_223772.pdf
- Marrëveshja e Brukselit (2013), nenet 9 dhe 14. E disponueshme në: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/FIRST_AGREEMENT_OF_PRINCIPLES_GOVERNING_THE_NORMALIZATION_OF_RELATIONS,_APRIL_19,_2013_BRUSSELS_en.pdf
- Zeri.info (2015). *Ish pjesëtarët e MUP-it serb protestojnë në veri*. I disponueshëm në: <https://zeri.info/aktuale/21126/ish-pjesetaret-e-mup-it-serb-protestojne-ne-veri/>
- M.Blejos & B.Elek (2014). *Integrimi i Policisë në Kosovën e Veriut: Progresi dhe sfidat e mbetura në zbatimin e Marrëveshjes së Brukselit*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Police_Integration_in_North_Kosovo_851241.pdf.
- Balkan Insight (2018). *Gjuhët: Problemi i Kosovës për të cilin askush nuk flet*. I disponueshëm në: <https://balkaninsight.com/2018/05/04/languages-the-kosovo-problem-nobody-talks-about-04-26-2018/>
- Kallxo.com (2019). *Eskaloni i protestës kundër hidrocentralit në Shtërpçë*. I disponueshëm në: <https://kallxo.com/eskalon-protesta-kunder-hidrocentralit-ne-shterpce/>
- Kallxo.com (2019). *Protesta në Shtërpçë, Policia përdor sprej për t'i shpërndarë protestuesit*. I disponueshëm në: <https://kallxo.com/protesta-ne-shterpce-policia-perdor-sprej-per-ti-shperndare-protestuesit/>

- Balkan Insight (2018). *Ivanoviç e përmendi Radojiçiqin si Sundimtarin e Errët të Kosovës së Veriut*. I disponueshëm në: <https://balkaninsight.com/2018/02/27/ivanovic-named-radoicic-as-north-kosovo-dark-ruler-02-26-2018/>
- Për më shumë mbi profilin e Zvonko Veselinoviçit dhe lidhjet e tij me krimin e organizuar dhe politikanët në Serbi ju lutemi lexoni: <https://www.krik.rs/en/serbian-presidents-brother-met-infamous-criminal/>
- Balkan Insight (2012). *Kontrabandistët e naftës në Kosovë të ndaluar për një muaj*. I disponueshëm në: <https://balkaninsight.com/2012/06/01/kosovo-petrol-smugglers-ordered-month-in-detention/>
- Iniciativa Globale Kundër Krimin të Organizuar Transnacional (2019). *Pikat e nxehta të Krimin të Organizuar në Ballkanin Perëndimor*. I disponueshëm në: <https://globalinitiative.net/wp-content/uploads/2019/05/Hotspots-Report-English-13Jun1110-Web.pdf>
- Kallxo.com (2019). *Haradinaj zbardh takimin e Hashim Thaçit me Milan Radojiçiqin*. I disponueshëm në: <https://kallxo.com/haradinaj-zbardh-takimin-e-hashim-thacit-me-milan-radoicic-in/>
- Balkan Insight (2018). *Vrasja e Oliver Ivanoviçit: Arrestimet e kryera deri më tani*. I disponueshëm në: <http://archive.balkaninsight.com/al/article/vrasja-e-oliver-ivanovi%C3%A7it-arrestimet-e-kryera-deri-m%C3%AB-tani-11-27-2018>
- Radio Slobodna Evropa (2019). *Vučić: Mislirio da imamo ime ubice Olivera Ivanovića*. I disponueshëm në: <https://www.slobodnaevropa.org/a/30034800.html>
- Sh. Balaj & T. Boshnjaku (2018). *Tendencat e shkatërrimit të multietnicitetit: Dorëheqjet masive të anëtarëve serbë nga Forca e Sigurisë së Kosovës dhe roli i Serbisë*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Policy_brief_eng_434386.pdf
- Radio Evropa e Lirë (2019). *Thellimi i ndarjeve të serbëve në Kosovë nga Beogradi*. I disponueshëm në: <https://www.evropaelire.org/a/ndarje-serbe-te-kosoves-beograd-30027557.html?nocache=1>
- D.Marku (2018). *Edicioni i 8-të i Barometrit Kosovar të Sigurisë*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/barometri2018-SHQIP_853983.pdf
- OSBE (2018). *Raport Tematik mbi Pajtueshmërinë me Gjuhët në Policinë e Kosovës*. I disponueshëm në: <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/396824?download=true>
- Prishtina Insight (2016). *Kosova, e humbur në përkthim*. I disponueshëm në: <https://prishtinainsight.com/kosovo-lost-translation/>

- OJQ Aktiv dhe CPT (2016). *Cilësia e përkthimit të ligjeve të Kosovës në gjuhën serbe*. I disponueshëm në: <http://ngoaktiv.org/uploads/files/Policy%20Brief%20-%20Quality%20of%20Translation%20of%20Kosovo%20Laws%20into%20Serbian%20Language.pdf>
- OSBE Profilet Komunale (2018)
- OSBE (2018). Raportimi i Dhunës në Familje. I disponueshëm në: <https://www.osce.org/sq/mission-in-kosovo/404351?download=true>
- P.Avidiu (2019). *Edicioni i Posaçëm i Barometrit Kosovar të Sigurisë - Korrupsioni, Sundimi i Ligjit dhe Integriteti Policor në Kosovë*. I disponueshëm në: http://www.qkss.org/repository/docs/Corruption_Rule_of_Law_ENG_Final_320893.pdf
- D.Marku (2019). *Barometri Kosovar i Sigurisë - Edicioni i posaçëm për Sigurinë Publike*

Katalogimi në botim – **(CIP)**

Biblioteka Kombëtare e Kosovës “Pjetër Bogdani”

351.746.1(496.51)(048)

Balaj, Shpat

Perceptimi i komunitetit serb kundrejt Policisë së Kosovës : mike apo armike? / Shpat Balaj. – Prishtinë : Qendra Kosovare për Studime të Sigurisë, 2019. – 30 f. ; 23/5 cm.

ISBN 978-9951-679-95-4

ISBN 978-9951-679-95-4



9 789951 679954

www.qkss.org